

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje barna e ndarë në lote B1/2024; B2/2024 dhe B3/2024 për mbulimin e nevojave 24 mujore”.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

*Produkte farmaceutike 33600000-6*  
*Artikuj Farmaceutike-33680000-0*

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

Vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë Marrëveshjes Kuadër: **122,842,318.39** (njëqind e njëzet e dy milion e tetëqind e dyzet e dy mijë e treqind e tetëmbëdhjetë pikë tridhjetë e nëntë) **lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor ***Qendra Spitalore Universitare “ Nene Tereza” Tirane*** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

**Argumentimi:** Ky kriter është pjesë e setit të Dokumenteve të Tenderit si dhe ne mbështetje me nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020“Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”,ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

**Argumentimi:** Ky kriter është pjesë e setit të Dokumenteve të Tenderit si dhe ne mbështetje me nenin 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se:

*Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.*

*Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:*

*a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;*

*b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”*

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

- a. Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë Licencën e lëshuar nga QKL ose QKB për tregtim me shumicë të barnave;**

**Argumentimi:** Ky kriter eshte vendosur ne perputhje me piken 1 te nenit 77 te Ligjin nr. 162/2020 ”Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ne te cilen gjejme te percaktuar se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe ne piken 1 te nenit 28 te Ligjin nr. 105/2014 “Per barnat dhe Sherbimin Farmaceutik”, i ndryshuar, ne te cilen eshte e percaktuar se: *Tregtimi me shumicë i barnave kryhet nga importuesi, eksportuesi, shpërndarësi farmaceutik, që është person juridik ose fizik, tregtar, vendas ose i huaj, i pajisur me licencën përkatëse për këtë veprimtari, sipas legjislacionit përkatës për licencimin”**

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

- a) Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjate 3 (tre) viteve te fundit (2021, 2022, 2023) ku vlera e xhiros per te pakten nje nga vitet e periudhes se kerkuar duhet te jete jo me e vogel se 40% e vleres se fondit limit\*.**

*Shënim\*:* Për efekt të përllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, vlera mesatare do te aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme të lotit/loteve për të cilen ofertohe, konkretisht mbi vlerat e kolonës “Vlera e pritshme e kontratave” ne piken 2.10 / 2.14 të DT.

*Nëse operatorët ekonomikë, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur.*

**Argumentimi:** Ky kriter, eshte vendosur ne perputhje me piken 3 te nenit 77 te Ligjit nr 162/2020,”Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, ne te cilin gjejme te percaktuar se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që*

garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.; ne piken 1 dhe piken 2/a të nenit 43 të VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, ku përcaktohet se: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimale deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar,(...); Vendosija e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet dokumenteve të kerkuara me poshte, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.

Legjislatori në ne piken 1 dhe piken 2/a të nenit 43 të VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur, ku përcaktohet; Pika 2/a: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; Referuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure AK ka menduar se vendosja e një vlere minimale të xhiros jo me e vogel se **40 % e vlerës së fondit limit\* për të cilat konkurron operatori, është një deshmi e mjaftueshme për të krijuar** bindjen tek Autoriteti Kontraktor se Operatorët Ekonomike ofertues zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.

---

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

**Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore** është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 ‘Mbi Rregullat e Prokurimit Publik’ ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimale deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 ‘Për Tatimin Mbi të Ardhurat’ i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

### 2.3 Kapaciteti teknik:

a) Dëshmi nga operatori ekonomik për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbime të mëparshme, të kryera gjatë tre viteve të fundit në një vlerë **jo më të vogël 20% e vlerës** së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe **që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme me një ent publik, **kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës**, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës së bashku me kontratën e lidhur ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm **fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore\***, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

***Shënim\****: Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 20% do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme për të cilin ofertohet, konkretisht mbi vlerat e kolonës “Vlera e pritshme e kontratave” në piken 2.10 / 2.14 të DT.

**Argumentimi**: Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar, në të cilin gjejmë të percaktuar se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me piken 4 të nenit 40 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, në të cilin është e percaktuar se: [...]4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.

### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe piken 4 te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më e vogël se **20 %** të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Autoriteti Kontraktor QSU “Nënë Tereza” Tiranë është institucion terciar Shëndetësor Publik Kombëtar në shërbim të shëndetit të popullatës, të cilës i siguron shërbim shëndetësor parandalues, diagnostikues dhe kurues sipas Kushtetutës së Shqipërisë dhe ligjeve të shëndetit publik. Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.

**b) Për barnat e autorizuara për tregtim në Republikën e Shqipërisë,** duhet të paraqitet dokument lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM) që bari i ofertuar është i pajisur me autorizim për tregtim në Republikën e Shqipërisë ose certifikatë regjistrimi e barit për tregtim në RSH, brenda afatit të vlefshmërisë.

**Argumentimi:** Ky kriter eshte miratuar dhe vendosur nga anetaret e Njesise se Prokurimit qe ka specialitetin perkatese ne lidhje me kriteret teknike, ne perputhje me piken 2 dhe 4, te nenit 77 te Ligjit nr. 162/2020, ”Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe ne piken 3 te nenit 3, ne piken 1 te nenit 1, ne nenin 17/1, 18 dhe 19 te Ligjit nr.105/2014 “Per Barnat dhe Sherbimin Farmaceutik”, i ndryshuar dhe shkresen nr. 2133/1 prot, datë 03.10.2024 “Relacion për llogaritjen e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe argumentimin e nevojave për procedurën e prokurimit me objekt ‘Blerje barna për 20 lote B1/2024, B2/2024, B3/2024’”, bashkelidhur kerkeses per hapje procedure nga Drejtoria e Sherbimit Farmaceutik nr. 2133/2 prot, datë 04.10.2024. Nga sa me siper cituam, cmojme se kerkimi i dokumentit qe parashikohet ne piken b) te kapacitetit teknik eshte ne perputhje me ligjin perkates per barnat dhe shërbimin farmaceutik në RSH.

### **c) Për barnat e paautorizuara për tregtim në Republikën e Shqipërisë, bari që ofertohet duhet:**

- të ketë marrë autorizim për tregtim dhe të qarkullojë në njërin nga vendet e Bashkimit Europian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanada, Turqi, Zvicër, Izrael, Japoni, Australi, Norvegji, Islandë dhe Mbretëri e Bashkuar; /ose/
- të jetë i prodhuar në vendet e Ballkanit, vetëm kur ka marrë autorizim për tregtim dhe qarkullon në vendin e tyre, /ose/
- te jetë i pajisur me autorizimin e tregtimit nga Agjencia Europiane e Vlerësimit të Barnave (EMA) ose Institucioni i Administrimit për Ushqimin dhe Barnat (FDA) i Shteteve të Bashkuara të Amerikës

### **Për këtë kërkohet që ofertuesi të paraqesë:**

- Deklaratë me anën e të cilës të konfirmohet se bari që ofron është i pajisur me autorizim tregtimi dhe qarkullon në një nga vendet e mësipërme ose që disponon autorizim tregtimi nga **FDA** ose **EMA**.

Në deklaratën e nëshkruar dhe të vulosur nga ofertuesi duhet të deklarohen: *Emri dhe adresa e plotë e Institucionit/eve të autorizuar që kanë leshuar autorizimin e tregtimit; Të dhëna kontakti për këto institucione (Tel, fax, e-mail, web-site); Data e lëshimit të autorizimit të tregtimit të barit që ofron, (pranë këtij institucioni) dhe periudhën e vlefshmërisë të këtij autorizimi.*

**Argumentimi:** Ky kriter është miratuar dhe vendosur nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit që ka specialitetin përkatës në lidhje me kriteret teknike, në përputhje me pikën 2 dhe 4, të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, "Për Prokurimin Publik", si dhe në nenin 12 dhe në nenin 14 të Ligjit nr.105/2014 "Për Barnat dhe Sherbimin Farmaceutik", i ndryshuar. Kërkimi i dokumentit që parashikohet në pikën c) të kapacitetit teknik është në përputhje me ligjin përkatës për barnat dhe shërbimin farmaceutik në RSH.

### **ç) Kërkohet Autorizim:**

- Në rastin e parashikuar në pikën "b" të kriterëve të kapacitetit teknik të DST, kërkohet Autorizim nga MAH (Mbajtësi i Autorizimit të Tregtimit) ose distributori i autorizuar (*ku të provohet/dokumentohet lidhja e këtij të fundit me MAH*) nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë barnat e tyre. Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm për të gjithë periudhën e kërkuar.
- Në rastin e parashikuar në pikën "c" të kriterëve të kapacitetit teknik të DST, kërkohet Autorizim nga MAH (Mbajtësi i Autorizimit të Tregtimit) ose nga prodhuesi ose distributori i autorizuar (*ku të provohet/dokumentohet lidhja mes këtij të fundit dhe MAH apo prodhuesit*) nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë barnat e tyre. Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm për të gjithë periudhën e kërkuar.

**Argumentimi:** Ky kriter gjendet mbështetje në nenin 11 dhe në nenin 12 të Ligjit nr. 105/2014 "Për Barnat dhe Sherbimin Farmaceutik" i ndryshuar. Duke qenë se për barnat e percaktuara tek pika b) e kapaciteti teknik bëhet fjale për tregtim të barna të autorizuar në vendin tone, atëherë dokumenti shoqëruar që e verteton këtë fakt është pikërisht Autorizimi për Tregtim nga mbajtësi i MAH (Mbajtësi i Autorizimit për Tregtim). Për barnat e percaktuara tek pika c) e kapaciteti teknik bëhet fjale për tregtim të barna të paautorizuara në vendin tone, atëherë dokumenti shoqëruar që kërkohet është Autorizimi për Tregtim nga mbajtësi i MAH (Mbajtësi i Autorizimit për Tregtim) ose Autorizim Prodhuesi nga i cili janë prodhuar barnat për të cilat një operator ekonomik oferton. Në këtë rast Autorizimi i Prodhuesit është nga vendi prodhues që e autorizon subjektin të tregtojë barnat objekt i kësaj procedure prokurimi. Autorizimi nga Prodhuesi është një dokument i domosdoshëm për t'u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që subjekti/shoqëria që disponon këtë dokument, autorizon operatorin ekonomik që ta furnizojë AK me produktet e tij; Domosdoshmëria e tij lidhet me garancinë e mallit të cilën e jep prodhuesi dhe jo operatori ekonomik ofertues (*Per me teper ref.Vendim i KPP nr.353/2014*). Gjithashtu vendosja e këtij kriteri

gjen mbeshtetje edhe tek pika 4, neni 77 i Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik" si dhe ne rekomandimin e APP nr. 3341/1 prot, date 20.03.2018 "Mbi hartimin e kriterëve per kualifikim ne dokumentat e tenderit te procedurave te prokurimit publik". Legjislacioni i lartpërmendur që rregullon qarkullimin e barnave në Republikën e Shqipërisë, përkatësisht ligji nr. 105/2014 [ndryshuar me ligjin nr. 109/2015, datë 15.10.2015; me aktin normativ nr. 5, datë 12.2.20212 ; me ligjin nr. 95/2022, datë 22.12.2022] ku në nenin 1 'Qëllimi' përcakton se: Ky ligj përcakton rregullat për prodhimin, vendosjen në treg, importin, eksportin, tregtimin, përdorimin, farmakovigjilencën, publicitetin, kontrollin e cilësisë dhe inspektimin e veprimtarive që lidhen me barnat për përdorim njerëzor në Republikën e Shqipërisë, me qëllim garantimin e shëndetit public; Në Nenin 5 'Autorizimi i prodhimit' dhe në vijim, parashikohen kushtet për barnat e prodhuara në vend ndërsa në Nenin 11 'Autorizimi i Tregëtimit' parashikohet se: *1. Barnat që vendosen në treg në Republikën e Shqipërisë për përdorim njerëzor duhet të jenë të pajisura me autorizim për tregtim nga Agjencia, dhe se 2. Në raste nevojash të shërbimit shëndetësor (për mjekim ambulator dhe/ose spitalor), për barna të cilat nuk kanë asnjë alternativë të ngjashme, e cila ka autorizim për tregtim nga Agjencia, ministri përgjegjës për shëndetësinë autorizon importimin e barnave, për të cilat nuk është lëshuar autorizim tregtimi nga Agjencia, sipas rregullave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.* Procedura e regjistrimit pranë AKBPM bëhet nga Prodhuesi, Mbajtësi i Autorizimit për Tregëtim [MAH] ose nga Distributori Zyrtar i Autorizuar i prodhuesit; Në Nenin 12 Aplikimi dhe praktika e dhënies së autorizimit të tregëtimit, parashikohet ndër të tjera se: *1. Aplikimi dhe praktika e dhënies së autorizimit të tregëtimit kryhen pranë Agjencisë nga prodhuesit vendas të licencuar, mbajtësi i autorizimit për tregtim ...;* Në Nenin 12/1 'Mbajtësi i autorizimit të tregëtimit lokal', 1. Veprimtaria e mbajtësit të autorizimit për tregtim lokal kryhet nga personi juridik, me seli në Republikën e Shqipërisë, që është i regjistruar sipas legjislacionit në fuqi. 2. Kriteret që duhet të plotësojë subjekti për veprimtarinë "mbajtës i autorizimit për tregtim lokal" dhe njohja e subjektit nga institucioni përgjegjës miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Pra siç mund të konstatohet lidhur me vendosjen e kriterit të veçantë të autorizimit të prodhuesit / distributorit të autorizuar (ku duhet të provohet lidhja me prodhuesin), një bar për përdorim njerëzor, nuk mund të vendoset në treg dhe të qarkullojë pa marrë më parë autorizimin për tregëtim pranë AKBPM.

Per sa me siper cituam, cmojme se kerkimi i dokumentit qe parashikohet ne piken ç) te kapacitetit teknik eshte ne perputhje me ligjin perkates per barnat.

**d)** Deklarate e ofertuesit mbi origjinen e mallit (vendi i prodhimit dhe kompaninë prodhuese / MAH) për barin e ofertuar.

**dh)** Operatori Ekonomik ofertues, duhet të paraqesë Autodeklarate për afatin e skadencës së mallit sipas përcaktimeve në specifikimet teknike të **Shtojces 6**.

**Argumentimi:** Kriteri i vendosur në germën **d)** dhe **dh)** është vendosur nga anetari i NjP qe ka specialitet perkatese ne lidhje me kriteret teknike si dhe eshte ne perputhje me nenin 4 pika 38/b,

nenin 36 dhe 77 te Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar. Deklarata mbi origjinen e mallit (kompaninë prodhuese dhe vendi prodhimit) si dhe deklarata per plotësimin e afatit te skadences se mallit të ofruar, eshte kerkuar ne menyre qe me ane te saj do te behet krahasimi i ofertes, barnave që ofertohen nga OE me autorizimin e prodhuesit dhe dokumentacionin teknik që do të paraqitet në SPE.

### **Shenim për operatorët ekonomik:**

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike<sup>1</sup>. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

- Autoriteti/enti kontraktor perpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t'i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit permbushes per keto pika do te jete kusht skualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor mund te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht skualifikimi.
- Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **II.Argumentimi i specifikimeve teknike**

---



## Shtojca 6.

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

“Blerje barna e ndarë në lote B1/2024; B2/2024 dhe B3/2024 për mbulimin e nevojave 24 mujore” konkretisht si më poshtë:

Nr	Sistemi	Principi aktiv	Formedoza	Njesia
2	Anestezi Reanimacion	Lot4 Thipental sodium	1 gram	Flakon
3	Barna Antineoplastike dhe immunomodulatore	Lot14 Crisantaspase	10000 UI	Flakon
4	Barna Antineoplastike dhe immunomodulatore	Lot 32 Mitoxantrone	2 mg/ml-10ml	Flakon
5	Barna Antineoplastike dhe immunomodulatore	Lot 33 Cytarabine	20mg/ml-5ml	Flakon
6	Barna hormonale sistemike dhe hormonet seksuale	Lot 52 Somatostatine	3mg/ml-1ml	Flakon
7	Sistemi kardiovaskular	Lot 97 Ranolazine	375mg	Tablete
8	Sistemi kardiovaskular	Lot 101 Nebivolol	5 mg	Tablete
9	Anti-infektive te pergjithshem	Lot 27 Human Rabies Immunoglobuline	150 UI/	Tablete/ Kapsule
10	Anti-infektive te pergjithshem	Lot 31 Amoxicillin + Acid Clavulonic	1gr+200mg	flakon
11	Gjaku dhe organet formuese te gjakut	lot 83 Sodium Chloride + Potassium acetate	500 ml	flakon
12	Sistemi nervor	Lot 112 Valproic Acid + Sodium valproate	145mg+333mg	tablete
14	Sistemi kardiovaskular	Lot 37 Amiodarone	150 mg /3ml-3ml	Ampule
16	Gjaku dhe organet formuese te gjakut	Lot 72 Phytomenadion (vitamin K)	10mg/ml-ml	ampule
17	Sistemi muskolo-skeletik	Lot 81 Suxamethonium chloride	100 mg	ampule
18	Sistemi respirator	Lot 104 Ambroxol	15mg/5ml-100 ml	ampule
19	Sistemi respirator	Lot 105 Salbutamol	5mg/ml-20ml	flakon
20	Psikiatrik	Lot 109 Paliperidone	3mg	tableta

**Specifikimet teknike** të përgjithshme për këto barna, janë si më poshtë:

- **Afati i skadencës:** Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më pak se 1/2 e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës /ose/ jo më pak se 1 vit nga data e lëvrimit të mallit. Në raste të veçanta, sipas nevojave të argumentuara, për disa barna lejohet që sasi të cilat konsumohen për një periudhë jo më shumë se 3 muaj, afati skadencës të jetë sa dyfishi i kohës së llogaritur për konsum.
- **Formë – doza, njësia dhe volumi** për secilin bar është detyruese të jetë sipas specifikimeve teknike.
- **Paketimi:** Mbi çdo paketim duhet të jetë shënuar emri i barit, formë - doza, kodi i barit, përqindja dhe përmbajtja, data e prodhimit dhe e skadencës, nr. i serisë, si edhe përveç pullës së kontrollit të barnave të aplikuar në paketimin e jashtëm/kutinë e ambalazhit të

tyre, barnat duhet detyrimisht të jenë të vulosura edhe me vulën me mbishkrimin “PËRDORIM SPITALOR - NDALOHET SHITJA”.

**Argumentimi: Specifikimet teknike** janë vendosur në baze të shkresës nr. 2133/2 prot, datë 04.10.2024, “Kërkesë për hapje procedure” të ardhur nga Drejtoria e Shërbimit Farmaceutik, bashkëlidhur shkresës nr. 2133/1 prot, datë 03.10.2024 “Relacion për llogaritjen e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe argumentimin e nevojave për procedurën e prokurimit me objekt ‘Blerje barna për 20 lote B1/2024, B2/2024, B3/2024’” në vijim të Urdhrit të Brendshëm nr. 418 (nr. 2133 Prot.), datë 20.08.2024, sipas sasive dhe formë/dozave të deleguara nga MSHSMS nëpërmjet shkresës nr. 3584/12 prot., datë 09.09.2024 administruar në QSUT me nr. 1925/2 prot., datë 10.09.2024, si dhe në përputhje me nenin 4, pika 38/b të **Ligjin nr. 162/2020**, “Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenin 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nënve **20** dhe **49** të **Ligjit nr. 105/2014** “Per Barnat dhe Sherbimin Farmaceutik”, i ndryshuar.

### Shtojca 7

#### FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Nr	Sistemi	Principi aktiv	Formedoza	Njesia	Planifikimi per 24 muaj QSUT
2	Anestezi Reanimacion	Lot4 Thipental sodium	1 gram	Flakon	13,000
3	Barna Antineoplastike dhe immunomodulatore	Lot14 Crisantaspase	10000 UI	Flakon	700
4	Barna Antineoplastike dhe immunomodulatore	Lot 32 Mitoxantrone	2 mg/ml-10ml	Flakon	300
5	Barna Antineoplastike dhe immunomodulatore	Lot 33 Cytarabine	20mg/ml-5ml	Flakon	15,000
6	Barna hormonale sistemike dhe hormonet seksuale	Lot 52 Somatostatine	3mg/ml-1ml	Flakon	1,000
7	Sistemi kardiovaskular	Lot 97 Ranolazine	375mg	Tablete	16,000
8	Sistemi kardiovaskular	Lot 101 Nebivolol	5 mg	Tablete	22,000
9	Anti-infektive te pergjithshem	Lot 27 Human Rabies Immunoglobuline	150 UI/	Tablete/ Kapsule	70
10	Anti-infektive te pergjithshem	Lot 31 Amoxicillin + Acid Clavulonic	1gr+200mg	flakon	2,000
11	Gjaku dhe organet formuese te gjakut	lot 83 Sodium Chloride + Potassium acetate	500 ml	flakon	5,000
12	Sistemi nervor	Lot 112 Valproic Acid + Sodium valproate	145mg+333mg	tablete	10,000
14	Sistemi kardiovaskular	Lot 37 Amiodarone	150 mg /3ml-3ml	Ampule	14,000
16	Gjaku dhe organet formuese te gjakut	Lot 72 Phytomenadion (vitamin K)	10mg/ml-ml	ampule	15,500
17	Sistemi muskolo-skeletik	Lot 81 Suxamethonium chloride	100 mg	ampule	12,000

18	Sistemi respirator	Lot 104 Ambroxol	15mg/5ml-100 ml	ampule	1,000
19	Sistemi respirator	Lot 105 Salbutamol	5mg/ml-20ml	flakon	3,000
20	Psikiatrik	Lot 109 Paliperidone	3mg	tableta	5,500

#### **Afatet e lëvrim:**

**Kontratat do te jepen brenda periudhës: Nga momenti i lidhjes se Marrëveshjes Kuader me OE te shpallur fitues për secilin lot, me afat perfundimtar 24 muaj nga data e nënshkrimit të MK.** QSUNT do të lidhë kontratë në bazë të nevojave të saj në çdo 4, 6 ose 12 mujor. Përjashtimisht këtij përcaktimi, autoriteti kontraktor mund të lidhin kontratë për çdo nevojë që del e paparashikuar dhe është e domosdoshme në çdo kohë.

Për çdo kontrate të lidhur brenda marrëveshjes kuadër, sipas përcaktimit më sipër, afatet e lëvrimit do te jene si me poshtë:

- 15% e sasisë së barit duhet të lëvrohet brenda 15 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
- pjesa e sasisë së mbetur duhet të lëvrohet deri në përfundim të kontratës dhe sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

**Argumentimi: Sasia dhe Grafiku i levrimit** jane vendosur ne baze te shkresës nr. 2133/2 prot, datë 04.10.2024, “Kërkesë për hapje procedure” të ardhur nga Drejtoria e Shërbimit Farmaceutik, bashkëlidhur shkresës nr. 2133/1 prot, datë 03.10.2024 “Relacion për llogaritjen e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe argumentimin e nevojave për procedurën e prokurimit me objekt ‘Blerje barna për 20 lote B1/2024, B2/2024, B3/2024’” në vijim të Urdhrit të Brendshëm nr. 418 (nr. 2133 Prot.), datë 20.08.2024, sipas sasive dhe formë/dozave të deleguara nga MSHSMS nëpërmjet shkresës nr. 3584/12 prot., datë 09.09.2024 administruar në QSUT me nr. 1925/2 prot., datë 10.09.2024, dhe ne perputhje me **piken 1 te nenit 40 te VKM-se Nr. 285, date 19.05.2021** “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, e ndryshuar, ne te cilen gjejme te percaktuar se: *1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvrimit të mallrave.*

#### **NJËSIA E PROKURIMIT:**